

VENDIM
Nr. 362, datë 16.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1158, DATË 13.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE, TË KONSUMUARA NË SERRAT ME NGROHJE, PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE E AGROINDUSTRIALE, TË CILAT PËRDOREN PËR NEVOJA TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në fjalinë e parë, fjalët “... solar dhe mazut ...” zëvendësohen me “... të specifikuara në sesionin IV “Nënproduktet e naftës” të shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, të cilat plotësojnë kërkesat dhe standardet, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nënproduktit “Naftë virgine”, të përshkruar me kodin 27 10 11 11...”.

b) Pas fjalëve “... të konsumuara ...” shtohen “... në industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier ...”.

c) shkronjat “a” dhe “b” shfuqizohen dhe zëvendësohen me shkronjën “a” me këtë përmbajtje:

“a) Skema e rimbursimit është proporcionale, si më poshtë vijon:

- gjatë tri viteve të para, 2011-2014, do të kryhet rimbursim 100% i akcizës;
- në vitin e katërt, viti 2015, do të bëhet rimbursim në masën 80% të akcizës;
- në vitin e pestë, viti 2016, do të bëhet rimbursim në masën 50%.

Subjektet, të cilat kanë përfituar rimbursim 100% të akcizës, në bazë të vendimit nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, do të vazhdojnë të marrin rimbursimin 100% deri në vitin 2014 dhe, më pas, sipas skemës proporcionale të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij vendimi.”.

2. Në pikat 2, paragrafi i parë, dhe 3, fjalët “... solar dhe mazut ...” hiqen, ndërsa pas fjalëve “... të konsumuara ...”, shtohen “... në industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier ...”.

3. Shtojca nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, që shërben si tabelë referuese për normativat e harxhimit të lëndës djegëse, për industrinë, objekte të këtij vendimi, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, bëhet nga drejtoria rajonale e tatimeve, ku është i regjistruar subjekti, në mënyrë automatike, pas paraqitjes së kërkesës.

5.1 Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i

regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar, në rast se kërkesa për rimbursim plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) subjekti nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;
- b) është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;
- c) nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute a penalitete pa u paguar;
- ç) ka deklarim të rregullt të TVSH-së.

5.2 Kërkesa për plotësimin e kriterëve të mësipërme për rimbursimin automatik vlerësohet nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore, të cilët procedojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës. Kërkuesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por atyre nuk do t'u kërkohej dokumente shtesë, përveç atyre të përcaktuara në këtë pikë. Ato kërkesa që nuk plotësojnë kushtet, do të dërgohen për kontroll dhe kërkuesit mund t'i kërkohej të paraqesë dokumente shtesë.

5.3 Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, drejtoria rajonale tatimore duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën e kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, pas miratimit të shumës për t'u rimbursuar.

5.4 Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

5.5 Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, si dhe mbi të aplikohen penalitetet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha